



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Përkthim B-A (1)

Ngarkesa: 6 kredite (= 60 orë mësimore); 1.5 Kredite Leksion(= 15 orë mësimore); 4.5 Kredite seminar (= 45 orë mësimore)

Viti / Semestri : Viti I, semestri I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: Master i Shkencave, ‘‘Përkthim Teknik-letrar dhe Interpretim’’

Kodi i etikës: Kodi i etikës, Universiteti i Tiranës (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të trajtojë përkthimin si proces dhe produkt, në ndërthurje me analizën gjuhësore dhe kulturore të teksteve, në nivelet mikro dhe makro.Të aftësojë studentët për të strukturuar dhe përcjellë në gjuhën shqipe efekte përkthimore të barasvlefshme ose të përafërta me tekstin origjinal në anglisht.Të forcojë ndërveprimin ndërmjet përkthimit dhe studimeve kulturore, përmes përzgjedhjes së materialeve autentike të mediave dhe literaturës anglishtfolëse.

Objektivat specifike lëndore:

- 1.Të trajtojë në mënyrë praktike dhe teorike dukuritë gramatikore, leksikore dhe stilistike të gjuhëve anglisht dhe shqip.
- 2.Të lidhë organikisht përkthimin me lëndë të tjera përmes një qasjeje shumëdisiplinore dhe ndërdisiplinore.
- 3.Të integrojë aftësitë personale dhe ndërpersonale në analizën dhe manipulimin e teksteve të stileve të ndryshme funksionale, me fokus në stilin funksional të medias.
- 4.Të zhvillojë kompetenca disiplinore, ndërdisiplinore dhe shumëdisiplinore për përballimin e sfidave në përkthim.

Rezultatet e pritshme:

Në fund të kursit studentët do jenë të aftë të

1. Të kenë një shkallë më të lartë ndërgjegjësimi në lidhje me rolin e përkthimit në procesin e komunikimit;
- 2.Ndërthurin përkthimin në procesin e mësidhënies dhe nxënies së gjuhës angleze;
- 3.Zhvillojnë më tej kompetencat e ndryshme disiplinore, ndërdisiplinore dhe shumëdisiplinore.
- 4.Të vendosin dhe të krijojnë një lidhje organike ndërmjet lëndëve të ndryshme dhe përkthimit në aspektin praktik dhe aplikativ në këndvështrimin e marrëdhënieve shumëdisiplinore dhe ndërdisiplinore;